



**Pozicioni i kontinenteve gjate silurianit te vonë**

Berthama e  
brendshme e  
ngurte

### **Siluriani**

443-417 milion vjet më parë

Ndryshimet gjatë kësaj periudhe patën një ndikim të rëndësishme mbi jetën në tokë. Klima u stabilizua duke i dhënë fund një periudhe çrregullimesh e paqëndrueshmërie. Niveli i detit u ngrit si rezultat i shkrirjes së akullnajave që shoqëruan stabilitetin klimaterik. Karakteristikë është shfaqja e koraleve, dhe evolucioni i peshqve. Kye volucion kapi jo vetëm peshqit pa nofulla, por shënoi shfaqjen e peshqve të ujrave të ëmbla dhe të atyre me nofulla. Për herë të parë shohim shenjat e jetës në stere përfaqësuar nga merimangat dhe shumëkëmbëshat, si dhe gjejmë fosile bimësh vaskulare.